



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 414, Datë 20.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË, NR 207, DATË 18.06.2021, “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHËM DHË ANËTARËT ZËVENDËSUES TË KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË**

Bazuar në nenin 149/a, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 159, pika 1, pika 2, germa i, nenin 160 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

V E N D O S I :

1. Në vendimin nr. 207, datë 18.06.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Anëtari i Këshillit z. Sokol Stojani zëvendëson z. Kostaq Beluri në Komisionin e Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, në Komisionin Disiplinor dhe si anëtar zëvendësues në Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.
 - b. Anëtari i Këshillit z. Ludovik Doda zëvendëson z. Moisi Duda në Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe znj. Eloida Goxhi si anëtar zëvendësues në Komisionin Disiplinor.
 - c. Anëtari i Këshillit z. Zeqir Hoda zëvendëson z. Vatë Staka në Komisionin e të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI
GENT IBRAHIMI